



# Natyra kuantike e dritës

---

Rrezatimi termik




---

Rrezatimi termik paraqet energji të emetuar në formë të valëve elektromagnetike







---


Çdo trup me temperaturë më të lartë se zroja absolute na paraqet rrezatim termik



---


Emetimi i këtyre valëve bëhet si rezultat i kalimit të atomeve nga gjendja e ngacmuar në gjendje normale





---

Rrezatimi i trupave që kushtëzohet nga temperatura e tyre quhet **rrezatim termik**. Rrezatimet e energjive tjera përveç energjisë së brendshme quhet **luminishencë**.



---

Nëse temperatura e trupave është afër 800 K, atëherë ata emetojnë valë infra të kuqe, kurse me nxehjen e trupave në temperaturë më të lartë se 800 K, atëherë ata fillojnë të ndriçojnë.



---

Rrezatimi i trupave varet nga  
vet natyra e trupave





---

Karakteristikë e rrezatimit termik  
është ekuilibri termik i rrezatimit.